



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.8 prot

Tepelenë, më 26 07.2026

PROCES-VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot më **20.07.2026**, në orën **11:15**, në **Bashkinë Tepelenë (kati i dytë)**, në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Përfaqësues të administratës së Bashkisë Tepelenë: **znj. Julinda Karteri, z. Gëzim Shehu, z. Spiro Kora.**

Në momentin e hapjes së mbledhjes ishin të pranishëm këshilltarët: **Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Vladimir Gjonca, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj, Esmeralda Bishani.**

N/Kryetari i Këshillit Bashkiak, **znj. Mjaftoni Zeraj**, Përshendetje pasi është kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, deklaroi të hapur mbledhjen dhe fillojmë me rendin e ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 26.06.2026.
3. **Projektvendim:** : “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Qershor 2026”.
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Qershor 2026”.
5. **Projektvendim:** “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 77 datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026” i ndryshuar
6. **Projektvendim:** “Për miratim të kërkesës, për heqje dore nga pasuria e paluajtshme me status juridik “Në përdorim të Bashkisë Tepelenë” me numër pasurie 66/2, 291, 318 dhe 338 ZK2404 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 485 sipas VKM nr. 386 datë 25.5.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kurvelesh të Qarkut të

Gjirokastrës” fusha e përdorimit Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)”

7. **Projektvendim:** “Për miratimin e modelit tip të strukturave të çmontueshme për njësitë tregtare ambulante në zonën turistike përgjatë aksit rrugor Tepelenë – Uji i Ftohtë –Hormovë
8. **Projektvendim:** “Për miratimin e masave administrative dhe nivelit të gjobave të aplikueshme në territorin e Bashkisë Tepelenë”.
9. **Projektvendim:** “Për miratimin e standardeve dhe vendosjen e sinjalistikës turistike për shtigjet, monumentet e kulturës dhe atraksionet turistike në territorin e Bashkisë Tepelenë”.
10. Çështje të tjera.
11. Trajtimi i kërkesa dhe ankesa të qytetarëve.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të dites: Jeni dakort me rendin e dites? Ta hedhim në votim.

Vota Pro 12: **Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Vladimir Gjonca, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj, Esmeralda Bishani.** Vota kundër: S’ka, Vota abstenim: S’ka

Pika e dytë e rendit të dites : Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 26.06.2026.

N/Kryetari i Këshillit; Ka pyetje? jo

Deklaroj hapjen e votimit.

Vota Pro 12: **Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Vladimir Gjonca, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj, Esmeralda Bishani.** Vota kundër: S’ka, Vota abstenim: S’ka

Pika e tretë e rendit të ditës Projektvendim: “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Qershor 2026”.

N/Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare komisionit ekonomisë: Ky material nuk ka ndryshime ndihme ekonomike me fond 6 %, përfitojnë 10 familje me fond **46095** lekë, Ftoj keshilltaret ta miratojnë .

Kryetari i Këshillit; Ka pyetje? Jo.

Deklaroj hapjen e votimit për miratimin e projektaktit

Vota Pro 12: **Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Vladimir Gjonca, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj, Esmeralda Bishani.** Vota kundër: S’ka, Vota abstenim: S’ka

Pika e katërt e rendit të ditës Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Qershor 2026”.

N/Kryetari i Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat:

Për muajin qershor do të trajtohen 90 familje me ndihmë ekonomike, fondi i bashkisë. Krahasuar me muajin e kaluar, ka 3 familje shtese. Relacioni shoqëruar ju është vënë në dispozicion. Ju ftoj ta miratojmë projektaktin.

N/Kryetari i Këshillit; Ka pyetje? Jo.

Deklaroj hapjen e votimit për miratimin e projektaktit

Vota Pro 12: Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Vladimir Gjonca, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj, Esmeralda Bishani. Vota kundër: S’ka, Vota abstenim: S’ka.

Pika e pestë e rendit të ditës: “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 77 datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026” i ndryshuar

Z.Spiro Kora: Përshëndetje ! Ky projektvendim ka për qëllim paraqitjen për shqyrtim dhe miratim të disa shtesave dhe ndryshimeve në buxhetin e Bashkisë Tepelenë për vitin 2026.

Ndryshimet e propozuara synojnë:

- reflektimin në buxhet të transfertave shtesë të akorduara nga Buxheti i Shtetit;
- përshtatjen e strukturës së shpenzimeve sipas nevojave të institucionit;
- mbështetjen e familjeve në nevojë në kushte të vështira ekonomike dhe shëndetësore;
- krijimin e një skeme mbështetjeje mujore me paketa ushqimore për familjet në kushte ekstreme ekonomike;
- mbështetjen e aktiviteteve tradicionale lokale në territorin e Bashkisë;
- realizimin e ndërhyrjeve të nevojshme në banesat ekzistuese të qytetarëve.

Ndihmë financiare për familjet në nevojë në kushte të vështira ekonomike dhe shëndetësore

Bazuar në kërkesat e qytetarëve të paraqitura pranë Këshillit Bashkiak Tepelenë me email, shkresa dhe kërkesa të regjistruara në protokoll, të cilat i janë përcjellë Administratës së Bashkisë për shqyrtim, si dhe pas vlerësimit të situatave të paraqitura, rezultoi se një numër familjesh/personash ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe shëndetësore.

Për trajtimin e këtyre rasteve propozohet përdorimi i fondit rezervë të Bashkisë Tepelenë

Lista e përfituesve është pjesë përbërëse e këtij relacioni (**Aneksi nr. 1**).

Mbështetje mujore me paketa ushqimore për familjet në kushte ekstreme ekonomike

Në bazë të kërkesave të ardhura nga Njësiti Administrative të Bashkisë Tepelenë dhe evidentimit të situatës sociale në territor, rezulton se një numër familjesh ndodhen në kushte ekstreme ekonomike dhe kanë nevojë për mbështetje me ushqimet bazë të shportës.

Për këtë arsye propozohet që familjeve përfituese t'u sigurohet çdo muaj paketë ushqimore në masën: **4,000 (katër mijë) lekë/muaj për familje**. Familjet përfituese do të propozohen nga Njësiti Administrative dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë, pas verifikimit të gjendjes ekonomike dhe sociale. Lista përfundimtare e familjeve përfituese do të miratohet nga Kryetari i Bashkisë. Shpërndarja e paketave ushqimore do të realizohet **derë më derë**, pranë banesave të familjeve përfituese, nga administratorët shoqërorë dhe personeli i Njësive Administrative. Ky shpenzim do të përballohet nga buxheti i Këshillit Bashkiak të miratuar për vitin 2026.

Lista e kërkesave të paraqitura është pjesë përbërëse e këtij relacioni (**Aneksi nr. 2**).

Mbështetje për organizimin e aktiviteteve tradicionale lokale në fshatra

Organizimi i festave lokale në fshatra është një traditë e rëndësishme e komuniteteve të territorit të Bashkisë Tepelenë, duke kontribuar në ruajtjen e vlerave kulturore, historike dhe sociale të zonave përkatëse.

Bazuar në kërkesat e Kryesive të Fshatrave dhe Njësive Administrative, propozohet mbështetja e një pjese të shpenzimeve, kryesisht për ndërhyrje dhe shërbime me karakter infrastrukturor, për organizimin e aktiviteteve lokale në:

- Dragot; Hormovë, Sinanaj, Gusmar, Rexhin–Nivicë.

Tavani maksimal i financimit të propozuar është:

400,000 (katërqind mijë) lekë.

Ky financim do të përballohet nga buxheti i Këshillit Bashkiak të miratuar për vitin 2026.

Likuidimi i shpenzimeve do të realizohet vetëm mbi bazën e dokumentacionit ligjor justifikues të paraqitur nga organizatorët e aktiviteteve dhe pas verifikimit të dokumenteve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin e fondeve publike.

Përshtatja e banesave ekzisruese (Rikonstruksioni i çative)

Me Vendimin nr. 14, datë 27.02.2025 të Këshillit Bashkiak, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 213/1, datë 13.03.2025, është miratuar realizimi i ndërhyrjes për rikonstruksionin e çative të banesave ekzistuese

Kjo ndërhyrje lidhet me banesa ekzistuese të cilat nuk janë pjesë e projektit:

“Përshtatje e banesave për familjet e pafavorizuara”.

Megjithëse kjo ndërhyrje është miratuar me vendimin e mësipërm ajo nuk është realizuar gjatë periudhës së mëparshme, pasi është pritur koordinimi dhe bashkëpunimi institucional me Ministrinë përkatëse për vijimin e procedurave dhe realizimin e ndërhyrjes.

Në periudhën në vazhdim propozohet realizimi i kësaj ndërhyrjeje me qëllim përmirësimin e kushteve të banimit të familjeve përfituese, eliminimin e problematikave të krijuara nga amortizimi i çative dhe përmirësimin e pamjes së zonave të banuara.

N/Kryetari i Këshillit; Ka pyetje?

Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat:

Lidhur me pikat 3, 4 dhe 5 të materialit propozoj të hiqet nga materiali shprehja nga buxheti i Këshillit Bashkiak, pasi këto shpenzime nuk mund të përballohen nga buxheti i Këshillit Bashkiak, i cili është planifikuar për veprimtarinë dhe aktivitetet e Këshillit.

Fjalën e mori z. Vladimir Bakiaj: Këto aktivitete festive janë përgjegjësi e Bashkisë dhe duhet të përballohen me fondet e saj. Nuk jam dakord që në material të përcaktohet se do të financohen nga fondi i Këshillit Bashkiak. Fondet e Këshillit janë të destinuara për funksionimin dhe aktivitetet e tij, prandaj nuk shoh të arsyeshme që ato të përdoren për qëllime që i përkasin Bashkisë.

Fjalën e mori z. Ditar Hodaj: Në material në listën e përfituesve për ndihmë financiare janë përfshirë persona që, sipas vlerësimit tim, nuk janë të gjithë familje në nevojë. Gjithashtu, nuk jam dakord që të miratohen transferta për organizimin e festave të fshatrave. Nëse ekziston mundësia për mbështetje financiare, ato të përdoren për familje në nevojë.

Fjalën e mori z. Spiro: Në material nuk bëhet fjalë për fondin e Këshillit Bashkiak. Fondi është parashikuar për të mbështetur dhe rritur performancën e Këshillit. Sa i përket listës së përfituesve, ajo është hartuar mbi bazën e propozimeve të administratorëve të njësive administrative dhe të drejtorisë përgjegjëse. Për çdo rast është administruar dokumentacioni i plotë.

Fjalën e mori znj. Julinda Karteri : Procesi i identifikimit të rasteve fillon në njësitë administrative, ku administratorët dhe kryesitë e fshatrave kryejnë verifikimet përkatëse. Kërkesat i përcillen Bashkisë dhe shqyrtohen me kujdes. Në rastet kur evidentohen parregullsi ose që nuk plotësojnë kriteret, ato nuk miratohen.

Fjalën e mori z. Mjaftoni Zeraj: Personat e përfshirë në listën e përfituesve të pakove ushqimore janë në gjendje për punë dhe nëse ekziston mundësia që ata të punësohen.

Fjalën e mori z. Ditar Hodaj: Kam rezervat e mia lidhur me shpërndarjen e pakove nuk jam dakord me dhënien e mbështetjes financiare se mund të krijojnë mundësi për abuzim, duke theksuar se shërbimet shëndetësore në vend ofrohen pa pagesë.

Fjalën e mori znj. Matilda Çela: Propozoi që mbështetja për familjet në nevojë të trajtohet nga fondit të Bashkisë dhe jo në formën e pakove ushqimore.

Fjalën e mori znj. Julinda Karteri,: Mbështetja mujore me pako ushqimore u jepet familjeve që ndodhen në kushte ekstreme ekonomike. Në këtë kategori përfshihen edhe familje që kanë anëtarë të sëmurë dhe që përballen me vështirësi të mëdha ekonomike e sociale.

BASHKIA

Fjalën e mori z. Mjaftoni Zeraj: Në listën e përfituesve po ka persona që nuk plotësojnë kriteret për të përfituar raste të rishikohen, ne pikat 3, 4 dhe 5 të këtij përvendimi të hiqet shprehja Këshilli Bashkiak, në mënyrë që të mos krijohet përshtypja se fondet përkatëse përballohen nga buxheti i Këshillit Bashkiak.

Ka pyetje?

Deklaroj hapjen e votimit për miratimin e projektaktit

Vota Pro 11: Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Miftar Meta, Vladimir Gjonca, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj, Esmeralda Bishani. Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: 1 vote

Projektvendim: "Për miratim të kërkesës, për heqje dore nga pasuria e paluajtshme me status juridik "Në përdorim të Bashkisë Tepelenë" me numër pasurie 66/2, 291, 318 dhe 338 ZK2404 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 485 sipas VKM nr. 386 datë 25.5.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kurvelesh të Qarkut të Gjirokastrës" fusha e përdorimit Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)"

Fjalën e mori z. Gëzim Shehu: Qëllimi kryesor i këtij akti është miratojë fillimin e procedurës për të kërkuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Gjirokastrë ç'regjistrimin nga kartela e pasurisë për sipërfaqet me numër pasurie nr. 66/2, 291, 318 dhe 338 ZK2404 sipas planvendosjeve bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim lënien në dispozicion për vazhdimin e procedurës për kalimin në pronësi të Z. Osman Çulli sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr. 314 datë 14.12.1991.

Kjo procedurë është në përputhje me legjislacionin sipas pikes I të këtij relacioni.

Ky vendim do të bëjë të mundur vazhdimin e procedurës për kalimin në pronësi të Z. Osman Çulli sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr. 314 datë 14.12.1991 të pasurive objekt i këtij projektvendimi.

N/Kryetare keshillit Mjaftoni; Keto parcela do hiqen nga bashkia Tepelenë me numër pasurie 66/2, 291, 318 dhe 338 ZK2404 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 485 sipas VKM nr. 386 datë 25.5.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kurvelesh të Qarkut të Gjirokastrës" fusha e përdorimit Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)", në mënyrë që kërkuuesi të vijojë procedurat e regjistrimit të pronave të përfituara nga ligji 7501/1991.

Z.Culli të drejtë të përfitojë këtë sipërfaqe toke dhe propozoi që të mbështetet kërkesa e tij, duke i hapur rrugë vijimit të procedurave për regjistrimin e pronës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ka pyetje? jo

ASHKIA TEPELENE
Deklaroj hapjen e votimit për miratimin e projektaktit

Vota Pro 12: **Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Vladimir Gjonca, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj.** Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: Ska

Projektvendim: "Për miratimin e modelit tip të strukturave të çmontueshme për njësi tregtare ambulante në zonën turistike përgjatë aksit rrugor Tepelenë – Uji i Ftohtë –Hormovë. Fjalën e mori znj. **Julinda Karteri** : Ne sot me iniciativën e Drejtorisë së promovimit dhe zhvillimit të industrisë së turizmit projekteve të huaja, diasporës dhe emigracionit, Drejtorisë e planifikimit kontrollit zhvillimit të territorit e cila ka dy materiale.

Për miratimin modelit tip të strukturave të çmontueshme për njësi tregtare ambulante të cilat do të vendosen në zonën turistike përgjatë aksit nacional Tepelenë - Uji i Ftohtë - Hormovë, me synim përmirësimin e kushteve të ushtrimit të aktivitetit tregtar, rritjen e standardeve estetike dhe funksionale të hapësirës publike, si dhe forcimin e imazhit turistik të Bashkisë Tepelenë. Zona turistike e Ujit të Ftohtë përfaqëson një nga pikat më të rëndësishme hyrëse dhe identitare të Bashkisë Tepelenë, duke pritur çdo vit mijëra vizitorë vendas dhe të huaj. Prej më shumë se 30 vitesh, në këtë zonë ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtarë ambulantë, të cilët zhvillojnë aktivitetin mbi bazën e kontratave të qirasë me Bashkinë Tepelenë dhe tregtojnë produkte tradicionale, artizanale dhe bujqësore karakteristike të krahinës. Megjithatë, infrastruktura ekzistuese nuk garanton kushtet minimale për zhvillimin e këtij aktiviteti. Aktualisht:

- Mungojnë strukturat mbrojtëse të unifikuara;
- Tregtarët ekspozojnë produktet në kushte jo të përshtatshme;
- Temperaturat e larta gjatë sezonit veror ndikojnë negativisht në cilësinë dhe sigurinë ushqimore të produkteve;
- Pamja vizuale e zonës paraqitet e fragmentuar dhe jo në përputhje me potencialin turistik të saj.

Kjo situatë është evidentuar edhe nga vetë tregtarët, të cilët, nëpërmjet një kërkesë drejtuar Bashkisë Tepelenë dhe Këshillit Bashkiak, kanë kërkuar një zgjidhje institucionale afatgjatë dhe kanë shprehur gatishmërinë për të kontribuar financiarisht në realizimin e saj.

N/Këshillit Ka pyetje? Jo

Deklaroj hapjen e votimit për miratimin e projektaktit

Vota Pro 11: **Mirela Varfi, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Vladimir Gjonca, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj.** Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: 1 vote

Projektvendim: "Për miratimin e masave administrative dhe nivelit të gjobave të aplikueshme në territorin e Bashkisë Tepelenë".

Matilda: Cili është qëllimi i këtij përvendimi që problematika do zgjidhet ?

Si do përcaktohet niveli i gjobave? Këto gjoba kush do ti monitoroj?

Ditar: Cfarë ndikim finaciar kanë?

Fjalën e mori znj. Julinda Karteri: Objektivi kryesor është krijimi i një kuadri të qartë ligjor dhe procedural për konstatimin, shqyrtimin dhe ndëshkimin e kundërvajtjeve administrative, duke garantuar që strukturat vendore të kenë mjetet e duhura për të parandaluar dhe sanksionuar shkeljet. Kryetari i Bashkisë ngriti një grup pune për hartimin dhe përgatitjen e këtij akti, i përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Organizative, Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Inspektorit Vendor të Mbrojtjes së Territorit (IVMT) dhe Policisë Bashkiake.

Projekt-vendimi është i strukturuar në krerë dhe nene specifike që përcaktojnë qartë të gjithë ciklin e trajtimit të një kundërvajtjeje administrative:

Rrethanat Lehtësuese dhe Rënduese (Nenet 16-17): Përcaktohen rastet kur sanksioni drejta e kundërvajtësit për t'u dëgjuar dhe procedurat që ndiqen kur shkelësi refuzon nënshkrimin ose nuk është i pranishëm.

Ankimi dhe Ekzekutimi (Nenet 21): Përcaktohet e drejta për ankim pranë Komisionit të Apelit në Bashki. Gjithashtu, parashikohen lehtësi financiare (zbritje 20% nëse gjoba paguhet brenda 5 ditëve) si dhe penalitetet për vonesat (kamatëvonesë 2% në ditë, pa kaluar masën e gjobës). **Strukturat Përgjegjëse (Nenet 27):** Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për miratimin e formularëve dhe akteve nënligjore, ndërsa Drejtoria Juridike, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve Vendore dhe Policia Bashkiake ngarkohen me zbatimin e plotë të këtij vendimi.

Në aspektin administrativ: Ky vendim fuqizon Policinë Bashkiake dhe inspektoratet vendore, duke rritur kontrollin mbi territorin dhe duke thjeshtuar procedurat e gjobëvënies përmes krijimit të një baze të dhënash të centralizuar.

Në aspektin financiar: Të ardhurat e gjeneruara nga sanksionet administrative dhe shpërblimet e dëmeve do të kalojnë tërësisht në buxhetin e Bashkisë Tepelenë, duke u riinvestuar në shërbime publike dhe përmirësim të infrastrukturës së qytetit.

Ky projekt-vendim plotëson një vakum procedural dhe përditëson kuadrin e masave administrative në përputhje me nevojat aktuale të territorit të ri të Bashkisë Tepelenë, duke shfuqizuar vendimet e mëparshme që nuk i përgjigjen më realitetit administrativ.

Vladimir Bakiaj: Gjobat që bashkëpunimi ka ARSH me Bashkinë sinjalistika në rruget nacionale jashtë funksionit

Fjalën e mori znj. Julinda Karteri : ARSH dhe bashkia Tepelene në krah të qytetarëve kur ka pasur problematika ka pasur bashkëpunim me ARSH dhe do bashkëpunojmë.

Miftar: Para dy vitesh është marrë një vendim për emërtim rruge në njësinë administrative Kurvelesh, nuk është vendosur pllaka, të vendoset pllaka (Dëshmor i Atdheut)

N/Keshillit Ka pyetje? Jo

Deklaroj hapjen e votimit për miratimin e projektaktit

Vota Pro 12: Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Mjaftoni Zeraj, Miftar Meta, Vladimir Gjonca, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj. Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: Ska

Fjalën e mori znj. Julinda Karteri : Pika 9 e rendit të ditës të shtyhet për një shqyrtim të mëtejshëm, me qëllim zhvillimin e një pune më të plotë dhe gjithëpërfshirëse, në këtë proces të përfshihet edhe një grup pune nga Këshilli Bashkiak, duke qenë se, sipas Planit të Punës për vitin 2026, Këshilli Bashkiak ka ndërmarrë një nismë lidhur me shtigjet turistike.

Për këtë arsye, kjo pikë të mos diskutohet në këtë mbledhjen dhe shqyrtimi i saj të shtyhet për në mbledhjen e radhës.

Çështje të tjera.

N/Këshilli Mjaftoni: Na ka ardhur një relacion nga Drejtoria e zhvillimit rural mbi konfliktin e krijuar në fshatin Mamaj në vendin e quajtur Gume .

Fjalën e mori znj. Gëzim Shehu: Bashkia Tepelenë ka zhvilluar procedurat e dhënies me qira sipas legjislacionit në fuqi për pasuritë nr.21 ZK2582 e llojit Arë me sipërfaqe 1.997 ha dhe nr.91/5 ZK2582 e llojit kullotë me sipërfaqe 9.3345 ha ndodhur në fshatin Mamaj, për të cilat janë lidhur respektivisht kontratat e qirasë nr.876 datë 20.04.2022 dhe nr.832 datë 25.04.2024 me fituesin e procedurës Fermer Fatjon Çiçi me Nipt: M28821578I, dhe gjatë procedurës së afishimit publik të këtyre pasurive nuk ka patur ankesa apo pretendime.

Pas lidhjes së kontratës së pare kanë shprehur pretendime pronësie (pa paraqitur dokumenta që vërtetojnë pronësinë) disa persona të fisit "Dervishaj" banor të qytetit të Tepelenës. Nga diskutimet e zhvilluara u arrit një marrëveshje për pasurinë nr.21 ZK2582, ku fermeri Fatjon Çiçi hoqi dorë nga pjesa më e madhe e pasurisë nr.21 për sipërfaqen prej 1.877 ha, nga e cila ngeli në kontratë 0.12 ha, dhe për sipërfaqen prej 1.877 ha u përsërit procedura e dhënies me qira të cilën e kanë kontratuar aktualisht 4 përfaqësues të fisit Dervishaj (sipas marrëveshjes së tyre me njëri-tjetrin). Këtë vit ka lindur përsëri konflikti edhe për pasurinë nr.91/5 ZK2582 për një pjesë të së cilës pretendojnë se ka qenë pronë e fisit Dervishaj, dhe nuk kanë lejuar vazhdimin e punimeve nga fermeri Fatjon Çiçi, konflikt të cilin edhe strukturat vendore të policisë së shtetit nuk kanë arritur ta zgjidhin dhe kanë kërkuar ndërhyrjen/ndihmën e Bashkisë Tepelenë për parandalimin e pëshkallëzimit të konfliktit. Nga matja e të dy hartave, pra harta e pasurisë nr.21/1 dhe nr.91/5 ZK2582 e dhënë me qira tek fermer Fatjon Çiçi dhe harta e paraqitur nga përfaqësuesit e fisit Dervishaj rezulton se bëhet fjalë për një sipërfaqe prej 2.4156 ha, të cilën kërkojnë që të hiqet nga kontrata e fermer Fatjon Çiçi (planvendosja bashkëlidhur).

Konflikti në terren për pronë të trashëguar pa dokumenta e kërkojnë me qera ata kërkojnë lidhje kontrate procedura ligjore është ndjekur sipas ligjit.

Fjalën e mori znj. Julinda Karteri : Po te kishte vendim të komisionit të kthimit kompensimit të pronave ne do prishnim kontratën .

Matilda: Ku ka konflikt, ju si Bashki të bëni degjese publike, dervishajt e kane kane pasur ate toke.

Fjalën e mori znj. Julinda Karteri : Nuk kanë pasur kontrate qiraje këta persona qe pretendojne.

N/Kryetare Keshilli Mjaftoni: Kur është dhënë tek cicajt kane bere kerkese dervishajt ?

Ne si keshill bëjmë kalim ne parim, procedurën e beni ju.

Fjalën e mori znj. Julinda Karteri : Miratimin në parim e bëni ju në zbatim të Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, me qellim për të siguruar të ardhura për bashkinë.

N/Kryetare Këshilli Mjaftoni: Ju po na vini ne djeni per konfliktin me anen e ketij relacioni, Bashkia të marë masat për ta zgjidhur nga ana ligjore këtë konflikt.

Mbyllet mbledhja e këshillit ora 12.41

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI

NË MUNGESË ME POROSI

N/KRYETAR MJAFTONI ZERAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCA E KËSHILLTARËVE
MBLEDHJA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË
Datë: 20.07.2026

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 20.07.2026 morën pjesë këshilltarët si më poshtë:

Nr	Emër	Mbiemër	Nënëshkrimi
1	ARBEN	GUMENI	
2	MATILDA	ÇELA	
3	DINO	DELIMI	
4	MIRELA	VARFI	
5	MJAFTONI	ZERAJ	
6	ESMERALDA	BISHANI	
	BESNIK	MAÇA	
8	LATIF	KAÇAJ	
9	MIFTAR	META	
10	ILIR	HASKA	
11	MARSELA	BALILI	
12	MARIOS	JORGO	
13	DITAR	HODAJ	
14	VLADIMIR	BAKIAJ	
15	VLADIMIR	GJONÇA	